



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUKË

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Nr. 1999/1 prot

Pukë, më 27.11.2024

**LENDË:** Dërgojmë informacionin e kërkuar

TOP CHANNEL

ZNJ. ALBINA HOXHA

Adresa: Rr. "17 Nëntori", Nr.20, Mëzez, Kashar, TIRANË

Në përgjigje të kërkesës suaj, të bërë me datë 28.10.2024, dërgojmë informacionin e kërkuar.

1. Buxheti vjetor i Bashkisë Pukë është 591.975.853 lekë.
2. Bashkia Pukë ka aplikuar në institucionet qendrore me projekte në thirrjet që janë hapur. Kemi paraqitur mbi 20 aplikime dhe jemi shpallur fitues në dy prej tyre. Arsyet e penalizimit në rastet e mosfitimit janë të ndryshme, që lidhen kryesisht me natyrën e projektit dhe mangësitë që shfaqen gjatë hartimit të tyre.
3. Projekti i fundit që kemi aplikuar është në fushën e emergjencave civile. Projektet hartohen në ekip, janë të trajnuar, por jo ekip të posaçëm.
4. Në zonën tonë trajtohen 269 familje me ndihmë ekonomike. 298 familje kanë persona që trajtohen me kemp. Bashkia Pukë ka mundësi të kufizuara, qoftë financiare, qoftë infrastrukturore për mbështetjen e tyre, Bashkia Pukë i mbështet me pako ushqimore, kryesisht në bashkëpunim me donator për raste festash.
5. Në bashkinë Pukë janë 40 familje të pastreha.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**KRYETARI**

**RROK DODAJ**

